



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
Nr 116/12 Prot Tiranë më 01/02/2023

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor në mbështetje të Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr 166 datë 27.04.2015; Rregullores së Brendshme të Institucionit; Organikës dhe Strukturës së Institucionit miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014 shpall 1 (një) vend vakant në Drejtorinë e Baletit si më poshtë vijon:

❖ Balerin Kategoria e Dytë (djalë);

Për ti dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhojë për ti krijuar mundësi pjesmarrjes më të madhe në numër të konkurrentëve TKOB nxjerrë njoftimin e saj 30 (tridhjetë) ditë përpara.

Audicioni për pozicionin e punës Balerin Kategoria e Dytë (djalë) do të mbahet në datën **09.03.2023 ora 10:00** në Sallën e Baletit, Kati III, brenda Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor.

Të gjithë ata kandidatë të interesuar për pjesmarrje për vendin vakant, duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Institucionit të TKOBAP-së **deri në datën 02/03/2023 ora 14:00** dokumentat origjinale ose fotokopje për regjistrim si më poshtë vijon:

Kriteret e përgjithshme (dokumentacioni)

1. Të ketë përfunduar Shkollën Kombëtare të Baletit brenda ose jashtë vendit;
2. Diplomë e përfundimit të shkollës dhe listë notash të noterizuara;
3. Fotokopje e dokumentit të identitetit të vlefshëm;
4. CV bashkangjitur me Foto;
5. Një kopje të Curriculum Vitae bashkëngjitur me Foto, (veprimtaria e 2 viteve të fundit e çertifikuar, programe shfaqjesh, recitalesh të ndryshme, si dhe të dhëna të tjera që plotësojnë figurën artistike, eksperiencë pune për pozicionin që konkurojnë, etj); Dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar këtë kriter.

Kriteret për vendin vakant ,balerin kategoria e dytë trupë (djalë)

1. Ushtrimet e baletit (të gjithë balerinët që marrin pjesë në konkurs);
2. Variacione nga repertori klasik botëror;
 - a. Një variacion klasik nga baleti “Liqeni i Mjelmave”;
<https://youtu.be/udEuGDpP0vY>
 - b. Një variacion klasik -zgjedhje e lirë nga balerinët konkurent;
3. Monolog neoklasik ose komteporan;
4. Kërkesa me lëvizje specifike mbi teknikën e duetit klasik;
5. Realizimi i një materiali të shkurtër koreografik (a prima vista).

MIRATOI
DREJTORI I PËRGJITHSHËM
ABIGEILA VOSHTINA

